



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

PLANI I INTEGRUAR

I MINISTRISË

2010

Mars 2010

Mesazhi i Ministrit

Në kuadër të zbatimit të objektivave të qeverisë për vitin 2010 dhe në mbështetje të masave të planifikuara, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, synon që nëpërmjet këtij programi të integruar të përmbushë detyrimet e saj dhe veçanërisht objektivat që lidhen me përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjen dhe administrimin e pyjeve, si dhe menaxhimin e drejtë të burimeve ujore.



Ministria synon, gjithashtu, të përmirësojë politikat në fushën e peshkimit, duke forcuar masat e kontrollit për mbrojtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të rezervave peshkore në vendin tonë.

Realizimi i objektivave të mësipërme bëhet i mundur nëpërmjet një planifikimi dhe përdorimi efektiv të fondeve buxhetore, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës, forcimin e kapaciteteve planifikuese dhe manaxhuese, rritjen dhe përdorimin me efikasitet të investimeve.

Të gjitha këto objektiva e synime të MMPAU-t kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, zbatimin e politikave të kujdeshme mjedisore për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe të degraduara, rritjen e sipërfaqeve me mbjellje të reja në pyje, përmirësimin e cilësisë së jetës, në përmbushje të gjithë detyrimeve dhe misionit të saj.

Fatmir MEDIU

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë.....	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë.....	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010.....	8
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë.....	14
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....	16
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European.....	17
Aneks 3	Investimet publike.....	19
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj.....	20
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit.....	21

Misioni i Ministrisë

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave harton dhe zbaton politika, strategji, programe dhe projekte, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit, përbërësve të tij dhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe rezervave peshkore, duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të këtyre rezervave; zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave dhe masave mbështetëse me qëllim mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimet e mëtejshme si dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe të degraduara; përafrimin e legjislacionit të fushës së mjedisit dhe të standarteve mjedisore në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian.

Politikat e ministrisë janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe burimeve natyrore si pyjet, ujërat, peshkimi duke synuar në rritjen e nivelit ekonomik dhe të cilësisë së jetës së brezave të sotëm dhe atyre që do të vijnë.

2. DOKUMENTAT STRATEGJIKË TË MINISTRISË

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007-2013 është dokumenti bazë që parashtron politikën shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Qëllimi përfundimtar i zbatimit të saj është plotësimi i detyrimit kushtetues ndaj shtetasve, që gëzojnë të drejtën e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjik, zhvillimit të Shqipërisë në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet përdorimit racional të pasurive natyrore, ruajtjes së tyre nga ndotja dhe degradimi, si dhe promovimi i vlerave mjedisore, për t'i kthyer ato në asete të rëndësishme të rritjes së mëtejshme ekonomike të vendit. Kjo strategji tashmë është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe është në zbatim.

Politika e këtij sektori është orientuar dhe hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Hartimi dhe sigurimi i zbatueshmërisë të të gjitha disiplinave ligjore në mbrojtje të mjedisit, për të arritur tregues të lartë të rivendosjes së tyre me efekte të prekshme në cilësinë e mjedisit. Transpozimi dhe zbatimi i kerkesave të Direktivave të BE në fushat e ajrit, ujrave, mbetjeve, ndotjes dhe rreziqeve industriale, kimikateve, zhurmave, natyres dhe biodiversitetit. Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht për aktivitetet që shkaktojnë ndotje të ajrit dhe/ose ujit, prekin potencialet e turizmit, dëmtojnë pyjet dhe shkaktojnë erozion të tokës. Monitorimi i të gjithë treguesve mjedisorë dhe adoptimi i standarteve të monitorimit mjedisor me ato të KE-së; Mbështetje ndaj iniciativave për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike. Mbështetje e iniciativave për mbrojtjen e shtresës së Ozonit. Trajtimi me përparësi i të gjitha "vatrave të nxehta mjedisore", me nivel të lartë ndotjeje, e trashëguar nga industritë e amortizuara, apo të krijuara rishtazi; Nxitja e përdorimit të teknologjive të pastra nga aktivitetet ekonomike. rritja e sipërfaqeve të gjelbërta, e zonave të mbrojtura, dhe informimi i publikut mbi gjendjen reale të mjedisit. Plotesimit të rrjetit perfaqesues të Zonave të Mbrojtura dhe krijimit të Rrjetit Ekologjik kombëtar si pjesë e Rrjetit Ekologjik Pan-Evropian. Hartimi dhe zbatimi i planeve të veprimit për llojet e faunes së eger dhe për habitatet e rrezikuara me interes për komunitetin evropian. Administrimi i aktivitetit të gjuetisë mbi bazat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm që siguron mbijetesën e tyre. Ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit.
- Menaxhimi i kujdesshëm i burimeve ujore dhe ekonomike të vlefshme edhe nga ana sociale dhe mjedisore. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të një sistemi bashkëmenaxhimi të përshtatshëm dhe një sistemi të besueshëm të grumbullimit të të dhënave për përmirësimin e licencimit dhe përafrimit të legjislacionit. Objektivi afatgjatë është krijimi i një sistemi bashkëmenaxhimi të qëndrueshëm ekonomikisht dhe ekologjik në favor të komuniteteve lokale dhe qëndrore.
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ujore dhe përmirësimi i cilësisë së burimeve ujore; Forcimi i kontrollit të shfrytëzimit të inerteve lumore me tendencë ndalimin e tyre; Forcimi i strukturave lokale në nivel të baseneve ujore, me qëllim mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të rezervave ujore; Forcimi i bashkëpunimit me vendet kufitare, për të koordinuar masat e përdorimit dhe shfrytëzimit të rezervave ujore ndërkufitare.

- Shtimi i sipërfaqeve të reja pyjore, rehabilitimi i sipërfaqeve të djegura dhe të degraduara, shtimi dhe mirëmbajtja e veprave ujëmbajtëse në kullota, kontrolli i fenomeneve të erozionit nëpërmjet ndërtimit të veprave hidroteknike, përmirësimit të menaxhimit të produkteve pyjore dhe jopyjore, i cili do të çojë në gjenerimin e të ardhurave. Politikat e ndërmarra në sektorin pyjor do të ndikojnë në përmirësimin e situatës aktuale të pyjeve dhe kullotave, rritjen e numrit të aktiviteteve, që do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve social-ekonomike në zonat rurale.



3 PROGRAMET BUXHETORE TË MINISTRISË

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e kushteve të punës, përmirësimin e direktivave menaxhuese dhe zhvillimin institucional. Zhvillimin e politikave dhe të strategjive të sektorëve mjedisor. Rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve natyrore. Rritjen e kapaciteteve menaxhuese për zhvillimin, përgatitjen dhe zbatimin e politikave, hartimin dhe zbatimin e ligjeve në përputhje me standartet e BE-së.

3.2 MBROJTJA E MJEDISIT

Politika e këtij programi konsiston në administrimin e qëndrueshem të mjedisit dhe mbrojtjen e tij, nëpërmjet hartimit të politikave dhe zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit duke bashkëpunuar me ministritë e linjes dhe organet e pushtetit vendor në drejtim të menaxhimit të ndotjes së ajrit dhe zhurmave, menaxhimit të mbetjeve të ngurta, menaxhimit të ujërave të ndotura, rehabilitimit të pikave të nxehta mjedisore, parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes industriale, menaxhimit të rreziqeve nga aksidentet industriale, menaxhimit të kimikateve. Mbrojtja e biodiversitetit (florës dhe faunës), shtimi dhe mirëmenaxhimi i zonave të mbrojtura si dhe mbrojtja e tokës nga degradimi dhe ndotja, janë gjithashtu komponentë të rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit.

3.3 MBËSHTETJE PËR PESHKIMIN

Politikat e këtij programi kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE, për përafrimin e tij në legjislacion dhe standarte me vendet e BE, nëpërmjet një menaxhimi të burimeve ujore të gjalla duke respektuar mjedisin dhe që të përbëjë një burim ushqimi, tregu, argëtimi dhe mirëqënieje për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Gjithashtu ka për qëllim zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, nëpërmjet inkurajimit të një shfrytëzimi të qëndrueshëm të resurseve peshkore dhe një ekuilibër të qëndrueshëm, midis disponibilitetit të resurseve dhe kapacitetit të peshkimit të flotës së peshkimit, forcimit të konkurrencës dhe të rendimenteve të operatorëve të peshkimit, promovimit të metodave të peshkimit dhe të prodhimit, duke respektuar mjedisin, dhënies së një mbështetje të përshtatshme të gjithë atyre që punojnë në sektor, mbështetjes së një zhvillimi të qëndrueshëm të zonave të peshkimit.

3.4 ADMINISTRIMI I UJËRAVE

Uji është një nga burimet më të rëndësishme dhe të domosdoshme për jetën dhe zhvillimin social-ekonomik të vendit. Politika e këtij programi konsiston në përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e qëndrueshëm të burimeve ujore, me qëllim të plotësimit të nevojave të ekonomisë, industrisë, bujqësisë, popullsisë etj. Objektivi tjetër përbën edhe menaxhimi i integruar i rezervave ujore dhe mbrojtja e ekosistemeve të baseneve të lumejve nga mbishfrytëzimi i inerteve. Hartimi dhe monitorimi i sasisë dhe cilësisë së ujërave, përbën një tjetër objektivi të politikave të

kësaj fushe. Në administrimin e rezervave ujore ka rëndësi dhe bashkëpunimi në nivel ndërkufitar për shfrytëzimin e rezervave ujore të përbashkëta.

3.5 ADMINISTRIMI I PYJEVE

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të resurseve pyjore dhe kullotsore, që sigurojnë dhe mbrojnë biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësinë ripërtëritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global, pa shkaktuar dëme në ekosisteme të tjera.



4 PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMEVE KRYESORE NË 2010

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme gjatë vitit 2010.

4.1 OBJEKTIVAT E POLITIKËS

4.1.1 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

- Përmirësimi i sistemit të informacionit për burimet njerëzore sipas kategorive, rretheve, nivelit arsimor për çdo punonjës.
- Përmirësimi i përdorimit të fondeve buxhetore në institucionet e varësisë nëpërmjet auditimit dhe asistencës.

4.1.2 Mbrojtja e Mjedisit

- Hartimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor në mbrojtje të mjedisit dhe përafrimi me "acquis comunitare" i 15 akteve ligjore perkatesisht: 3 ne fushen e ajrit, 7 ne fushen e mbetjeve, 1 ne fushen e ndotjes se ujerave, 2 ne fushen e ndotjes industriale, 1 ne fushen e zhurmave, 5 ne fushen e mbrojtjes se natyres, perfshire shpalljen e nje zone te mbrojtur detare dhe hartimi i planeve te menaxhimit per 2 zona te mbrojtura;
- Menaxhimi i procesit të monitorimit të mjedisit dhe informimi i publikut mbi rezultatet e tij,
- Ulja me 3% e emetimit të gazeve sere dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike per Derdhjen e Lumenjeve Drin dhe Mat (DLDM).
- Reduktimi i shkarkimeve ne mjedis (ajer, ujera, toke), qe vijne nga aktivitetet industriale duke synuar rritjen e numrit te impianteve te trajtimit te shkarkimeve ne ajer dhe ujera te instaluar nga operatoret industriale
- Mbyllja perfundimtare te karrierave lumore ne zonat e ndaluar brenda vitit 2010 dhe pastrimin e zonave te mbrojtura nga aktivitetet minerare dhe sherbimet e paligjshme.
- Mbështetje ndaj iniciativave për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përdorimit të burimeve energjitike të rinovueshme,
- Zbatimi i projekteve të reja në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta mjedisore,
- Mbështetje e iniciativave ligjore dhe rritjes se kapaciteteve kombetare për mbrojtjen e shtresës së Ozonit,
- Shpallja e nje zone te mbrojtur detare duke rritur me 1 % siperfaqen e ZM-ve
- Miremenaxhimi i Zonave te Mbrojtura nepermjet zbatimit te planeve te menaxhimit per te gjitha parqet kombetare;
- Mbrojtja e biodiversitetit, e llojeve të rrezikuara e endemike të florës dhe faunës.

- Shtimi i sipërfaqes dhe përmirësimi i menaxhimit sipas standarteve të IUCN-së i zonave të mbrojtura .
- Ndermarrja e masave të domosdoshme për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në kuadër të konventave dhe protokolleve për mjedisin dhe natyrën.

4.1.3 Mbështetje Për Peshkim

Objektivat e politikës janë në përputhje me pikën 2.4.5 të Strategjisë Ndërsektoriale të Mjedisit. Gjithashtu, me qëllim që politika të jetë afatgjatë, nevojitet që ajo të jetë në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE- së më poshtë:

- menaxhimi dhe mbrojtja e resurseve
- mbrojtja e mjedisit
- politika strukturore
- menaxhimi i flotës
- organizimi i tregjeve
- kontrolli dhe zbatimi i politikës

4.1.4 Administrimi i Ujërave

- Plotësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e rezervave ujore dhe përafrimi i legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian.
- Forcimi organizativ dhe i kontrollit të Agjencive të Ujit për zbatimin e legjislacionit në fushën e përdorimit të rezervave ujore dhe shfrytëzimit të inerteve.
- Rritja e të ardhurave të buxhetit të shtetit nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm dhe lufta kundër korrupsionit.
- Mbrojtja e ekosistemeve lumore, nëpërmjet ndalimit të aktiviteteve të paligjshme dhe reduktimit të shfrytëzimit të inerteve lumore.
- Bashkepunimi me shtetet fqinje për shfrytëzimin e rezervave ujore të përbashkëta.

4.1.5 Administrimi i Pyjeve

- Forcimi i zbatueshmërisë së kuadrit ligjor në parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në fondin pyjor dhe kullotësor.
- Modernizimi i kadastrës së fondit pyjor dhe kullotësor për të tre nivelet lokal, rajonal dhe kombëtare.

- Hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale të integruar me pjesëmarrje të komunitetit.
- Rritja e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit, si dhe nëpërmjet stimulimit të ripërtëritjes natyrale të pyjeve dhe kullotave të degraduara, apo të djegura.
- Parandalimin e degradimit të tokës pyjore dhe kullotësore, nëpërmjet ndërtimit të veprave hidroteknike dhe biologjike.
- Krijimi i strukturës së shërbimit këshillimorë në nivel qendror, rajonal dhe lokal, me qëllim mbështetjen me asistencën e nevojshme teknike për pronarët privat, njësitë vendore dhe të përdoruesve të pyjeve.

4.2 PRODUKTET KRYESORE QË SYNOHET TË OFROHEN

4.2.1 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Realizimi i 12 auditimeve financiare në institucionet vartëse.

- Staf i trainuar në masën 10%, nëpërmjet seminareve të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.

4.2.2 Mbrojtja e Mjedisit

- Hartimi i Strategjise Kombetare dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Mbetjeve.
- Hartimi i 2 Planeve Rajonale të menaxhimit të Mbetjeve për Qarkun e Tiranës dhe Elbasanit.
- Hartimi i Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
- Hartimi i VKM për incenerimin e mbetjeve; Lanfillet e mbetjeve; Landfillete Automjeteve në fund të jetes; Ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet; Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike; Mbetjet nga baterite dhe akumulatoret, Masat për Minimizimin dhe Heqjen nga Përdorimi të Ambalazheve Plastike, për POP-set etj,
- Hartimi i Planit Kombëtar të menaxhimit të zhurmave.
- Amendimi i Ligjit nr.8897, dt.16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Hartimi i VKM për
- Hartimi i ligjit "Për Kontrollin e Aksidenteve nga Rreziqe të Medha, Lidhur me Substanca të Rrezikshme"
- Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Konventës së Efekteve Ndërkufitare nga Aksidentet Industriale. Hartimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për 3 protokollet e Konventës së Ndotjes së Ajrit në Distançë të Largët.
- Përmirësimi i procedurave të licensimit dhe mirëfunksionimi i inspektoriatit të mjedisit, në bashkëpunim me strukturat lokale.

- Rritja e frekuencës së matjes së treguesve të mjedisit 3% në shkallë vendi.
- Grumbullimi i të dhënave mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe krijimi i një sistemi të planifikimit dhe kontrollit të cilësisë së ajrit, në nivel kombëtar dhe lokal.
- Kryerja e inventarit kombëtar të shkarkimeve në ajër si pjesë përbërëse e regjistrit kombëtar të shkarkimeve dhe transferimeve në mjedis.
- Krijimi i sistemit për identifikimin e instalimeve të mëdha industriale, që do t'i nënshtrohen aplikimit për leje të integruara mjedisore.
- Krijimi i sistemit për identifikimin e instalimeve të mëdha industriale, që mbajnë, prodhojnë substanca të rrezikshme.
- Përgatitja e dokumentit final, të programit kombëtar, për futjen e paneleve diellore për ujin e ngrohtë.
- Ngritja e sistemit të monitorimit të ndryshimeve klimatike dhe impaktit të tyre në ekosistemin e lumenjve Drin-Mat, si dhe masat adaptuese.
- Përgatitja e NAMA-s, masave të përshtatshme zbutëse për reduktimin e gazeve serë.
- Aktivitet trajnuese kombëtare për autoritetet vendore lidhur me Ndryshimet Klimatike.
- Ngritja e kapaciteteve në sektorin publik dhe privat për të mundësuar financimet e karbonit në Shqipëri.
- Rritja e kapaciteteve, në nivel kombëtar, lidhur me aplikimin e prodhimeve të pastra në fushën e industrisë minerare, agro-ushqimore dhe hoteleri.
- Studim i thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për 10 pikat e nxehta me prioritet të identifikuara.
- Hartimi i Planeve të rehabilitimit të 10 hotspotëve më prioritare.
- Rehabilitimi i hotspotit të Balezes, Repsit dhe Rreshenit.
- Inventari i të gjithë aktiviteteve dhe paisjeve, që përdorin lëndë ozon holluese (LHO).
- Asistencë teknike në fushën e rikuperimit dhe riciklimit të Lëndëve Ozon Holluese.
- Hartimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura, Parku Kombëtar i Butrintit, Rezervati Natyror i Menaxhuar i Kune-Vainit.
- Ngritja dhe Funkionimi i Komiteteve të Menaxhimit të Parqeve Kombëtare kryesore.
- Decentralizimi i kompetencave tek organet e qeverisjes vendore, për shpalljen dhe menaxhimin e parqeve natyrore rajonale.
- Ristrukturimi i rrjetit ekzistues të zonave të mbrojtura në zonat e Kune-Vainit, në Lezhë dhe Patok-Fush Kuqe, në Kurbin dhe përshtatje e tyre me kategoritë e menaxhimit sipas standarteve të IUCN-së.
- Krijimi i zonave të mbrojtura në ekosistemet natyrore detare të Qarkut të Vlorës

- Hartimi i planit të menaxhimit për 1 zonë të mbrojtur;
- Riformatimi i administratave të ZM-ve në kuadër të reformës në strukturat e MMPAU;
- Rishikimi i procedurave për gjuetaret e huaj dhe subjektet e gjuetisë turistike;
- Zbatimi i planeve të menaxhimit të ZM-ve;
- Forcimi i kapaciteteve të administrative të ZM-ve;
- Ngritja e kapaciteteve të organeve të kontrollit të ngarkuara për zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit të faunës së eger;

4.2.3 Mbështetje për Peshkimin

Për menaxhimin dhe mbrojtjen e resurseve

- Hartimi i ligjit të ri “Për Peshkimin” dhe Ligjit të ri “Për Akuakulturën”;
- Prodhimi i rasave të koranit (1 milion/copë), të krapit (500 000/copë) dhe programe ripopullimi;
- Grumbullimi i të dhënave sociale dhe ekonomike në peshkim dhe akuakulturë;
- Monitorimi i gjendjes së resurseve peshkore në det;
- Menaxhimi i porteve të peshkimit dhe infrastrukturës së peshkimit.

Politika strukturore

- Projekt ide për merkatë në Sarandë, Vlorë, Durrës dhe Shëngjin;
- Projekt i plotë i zbatimit për ndërtimin e merkatos në Shëngjin;
- Fillimi i ndërtimit të portit të ri të peshkimit Durrës;
- Masterplani i zhvillimit të porteve të peshkimit;
- Projekti i zbatimit të bankinës në Shëngjin.

Menaxhimi i flotës së peshkimit

- Hartimi i rregullores për numrin e anijeve të peshkimit në det.

Kontrolli dhe zbatimi i politikës

- Ushtrimi i 800 kontrolleve në të gjithë kategoritë ujore;
- Trajnim i Inspektoratit të peshkimit, me mbështetjen e IPA 2008;
- Bashkëpunim me QNOD për kontrollet në det të aktivitetit të peshkimit;

4.2.4 Administrimi i Ujërave

- akte ligjore dhe nenligjore të ndertuara
- Ndërtimi i regjistrit të lejeve për shfrytëzimin e burimeve ujore dhe të inerteve;
- 1050 monitorimeve të kryera në të 6 basenet ujëmbledhëse të vendit për një shfrytëzim sipas normave ligjore të përcaktuar në lejet e lëshuara për këtë qëllim dhe sipas tarifave të miratuara për rezervat ujore.
- Lidhja e 10 kontratave koncensionare me përdorues të rezervës ujore.
- Pajisja me leje e 30 përdoruesve të rezervës ujore me pus-shpime
- Organizimi i 2 takimeve të grupeve të përbashkëta për ujërat ndërkufitare.

4.2.5 Administrimi i Pyjeve

- Ushtrimi i 120 kontrolleve për zbatimin e ligjit në veprimtaritë që ushtrohen në fondin pyjor dhe kullotësor.
- Përfundimi dhe miratimi i 71 planeve të reja të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale, në 71 njësi të qeverisjes vendore për një sipërfaqe prej 280 mijë ha, të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.
- Riorganizimi i kadastrës së fondit pyjor/kullotësor, si bazë për ruajtjen e tërësisë së këtij fondi, në 12 qarqe.
- Hedhja e të dhënave nga planet e mbarështimit dhe inventarizimit në database, përgatitja e hartave dixhitale për 50 ekonomi pyjore/kullotësore.
- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i 248.7 ha, nga të cilat 128.7 ha, të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.
- Ndërtimi i 1146 m³ prita malore me mure guri të thatë dhe gardhe çift të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.
- Ripërtëritje të pyjeve të degraduar, nëpërmjet pastrimeve dhe ricungimeve në një sipërfaqe prej 500 ha, të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.
- Shtimi i kapacitetit kullotësor, nëpërmjet përmirësimit të një sipërfaqeje kullotësore prej 650 ha, të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.
- Krijimi i strukturës së shërbimit këshillimor në 12 rajone dhe 36 zyra të shërbimit pyjor në rrethe.
- Trajnimi i 150 punonjësve të shërbimit këshillimor të nivelit kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe trajnimi i 50 specialistëve të kadastrës dhe GIS, të financuar nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.

Tabela Buxheti 2010 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milionë Lekë

Programi	Paga + Sigurime Shoqërore 600, 6001	Mallra dhe Shërbime 602	Subvencione 603	Transferta e brendshme 604, 605	Transferta Për Buxhetet Familjare Dhe Individët 606	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara 230, 231	Totali
Planifikim Menazhim Administrativ	51,000	14,800	0	7,000	1,200	10,000	84,000
Mbrojtja e Mjedisit	69,000	25,000	0	13,000	0	321,720	428,720
Mbështetje për peshkim	43,000	27,000	0	0	0	257,000	327,000
Administrimi Ujërave	20,600	10,000	0	0	0	0	30,600
Administrimi Pyjeve	687,400	207,000	0	10,000	0	326,000	1,230,400
Totali	871,000	283,800	0	30,000	1,200	914,720	2,100,720

5 PLANI I MONITORIMIT I MINISTRISË

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2010.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI		
Realizimi i auditimeve financiare në institucionet vartëse.	nr	14
PROGRAME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT		
Hartimi i akteve ligjore të reja dhe plotësimi i atyre ekzistuese në fushën mjedisit	nr	25
Rritja e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura	ha	15 mijë
Ngritja e Komiteteve të Menaxhimit për Parqet Kombëtare	nr.	5
Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura	nr	2
Identifikimi i pikave të reja të nxehta mjedisore.	nr	10
MBËSHTETJE PËR PESHKIM		
Ushtrimi i kontrolleve për zbatimin e ligjit të peshkimit	nr.	800
Prodhimi i rasateve të koranit dhe krapit	copë	2 milion
Projekt idete për merkatot në portet e peshkimit, dhe projekti i zbatimit të merkatos së Shëngjinit. Masterplani i zhvillimit të porteve të peshkimit dhe projekti i zbatimit të bankinës së Shëngjinit	copë	6
ADMINISTRIMI I UJËRAVE		
Hartimi i akteve ligjore dhe nenligjore	Nr.	4
Monitorimi i subjekteve të licensuara në basenet e 6 lumenjve të vendit.	nr.	1050
Lidhja e kontratave konçensionare me përdorues të rezervave ujore	nr.	10
Pajisja me leje shfrytëzimi e përdoruesve të ujit në pusçpime	nr.	30
Organizimi i takimeve të përbashkëta ndërkufitare për komitetet e përbashkëta	nr.	2
ADMINISTRIMI I PYJEVE		
Ushtrimi i kontrolleve për zbatimin e ligjit në veprimtaritë që ushtrohen në fondin pyjor dhe të kullotave	nr	120

Përfundimi dhe miratimi i planeve të reja të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale në njësitë e qeverisjeve vendore për një sipërfaqe prej 280 mijë ha, të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.	nr	71
Riorganizimi i kadastrës së fondit pyjor dhe të kullotave, si bazë për ruajtjen e tërësisë së këtij fondi në qarqe.	nr	12
Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura, të degraduara dhe të djegura në një sipërfaqe prej 248.7 ha, nga të cilat 120 ha nga buxheti dhe 128.7 ha të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.	ha	248.7
Hedhja e të dhënave nga planet e mbarështimit dhe inventarizimit në database, përgatitja e hartave dixhitale për ekonomi pyjore dhe të kullotave.	nr	50
Ndërtimi i pritave malore me mure guri të thatë dhe gardhe çift të financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.	m ³	1146
Ripërtëritje të pyjeve të degraduara nëpërmjet pastrimeve dhe ricungimeve me financim nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore	ha	500
Shtim të kapacitetit të kullotave, nëpërmjet përmirësimit të sipërfaqeve të kullotave me financim nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.	ha	650

Aneks 1 PROJEKT-AKTET PËR T'U PARAQITUR

- Ligji "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji "Për Rezervat ujore"
- Ligj për aderimin e R.SH. në Marrveshjen e Mbrojtjes së Drurëve Tropikal
- Ligji "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- Ligji "Për pajisjen me leje mjedisi të veprimtarive me ndikim në mjedis"
- Ligj "Për peshkimin"
- Ligj "Për akuakulturën intensive"
- Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit "Për zonat e mbrojtura" (amendim)
- Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të kontrollit në mjedis".
- Ligji "Për administrimin e mbetjeve"
- Ligji "Për POPs-et"
- Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- VKM "Për planet e menaxhimit të bazeneve të lumenjve",
- VKM "Për shpalljen Zonë të Mbrojtur të Ekosistemit Natyror Ligatinor "Patok - Fushëkuqe-Ishëm"
- VKM "Për procedurat e propozimit, miratimit dhe rregullat e administrimit të Parqeve Natyror Rajonale"
- VKM "Për miratimin e Planit Kombëtar të Zhurmave"
- VKM "Per incenerimin"
- VKM "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota"
- VKM "Për informimin e publikut"
- VKM "Për miratimin e normave të punimeve për aktivitete në pyje dhe kullota"
- VKM "Për kontrollin e aksidenteve nga rreziqe të mëdha, lidhur me substanca të rrezikshme"
- VKM "Për landfillin e mbetjeve"
- VKM "Për ambalazhimin dhe mbetjet nga ambalazhet"
- VKM "Per landfillet e automjeteve në fund të jetës"
- Projektvendim i KKU-së për hartimin e regjistrit të lejeve për shfrytëzimin e ujërave dhe të inerteve.

Aneks 2 REZULTATE QË LIDHEN ME INTEGRIMIN EUROPIAN

Iniciativat Ligjore

- P/Ligj "Per mbrojtjen e mjedisit"
- P/Ligji "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
- P/Ligj "Për aderimin në "Protokollin për financimin afat-gjatë të programit bashkëpunues për monitorimin dhe vlerësimin e transferimit të ndotësve të ajrit në distanca të mëdha në Europë"" (EMEP) (Gjenevë 1984)
- P/Ligji "Për aderimin në "Protokollin për metalet e rënda" (Aarhus 1998)"
- P/Vendim i KKKU "Për hartimin e regjistrit të lejeve për shfrytëzimin e ujërave dhe të inerteve".
- Rishikimi i ligjit Nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", i ndryshuar.
- Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Ujit, hartuar në kuadër të programit Phare në Shkurt të 1997 dhe miratuar me VKM nr 273, dt 7/5/2004
- P/Ligj "Për menaxhimin e mbetjeve"
- Projektvendim "Për landfillin e mbetjeve"
- Projektvendim për miratimin e planit kombëtar të administrimit të mbetjeve
- Projekt-akt "Për ambalazhimin dhe mbetjet e ambalazheve".
- Projektakt "Për landfillet e automjeteve në fund të jetës"
- VKM "Për incinerimin e mbetjeve" .
- VKM "Për informacionin mjedisor"
- Projekt VKM për paketimet dhe mbetjet e paketimit.
- Projekt-akt "Për kontrollin e rreziqeve të aksideneteve industriale lidhur me substanca të rrezikëshme".
- Projektligji që do të përfshijë transpozimin e dy Direktivave : Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjeve (IPPC); Impiantet e Mëdha të Djegies, (LCP);
- Draft akt për shkarkimet në ujëra.
- VKM "Për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore me këmbë dhe ruajtja e trajtimi i pyjeve të virgjëra".
- Projekt vendim "Për krijimin e rezervateve farore dhe konservimin e germoplazmës për disa nga llojet pyjore kryesore".

Aktivitetet Zbatuese

- Trajnime dhe seminare me organet planifikuese për zbatimin e Ligjit të Vleresimit Strategjik Mjedisor.
- Takime për forcimin e strukturave qendrore dhe vendore lidhur me procesin dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor.
- Trajnime të stafit të drejtorisë dhe ARM-ve për zbatimin e Ligjit nr. 9700 date 26. 03. 2007 "Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkuftare", në zbatim të detyrimeve të Konventës së Espoos.
- Bashkëpunimi për organizimin e debateve publike. - Informimi, në kuadër të zbatueshmërisë së Konventës së Aarhus-it, përfshirja në proceset vendimmarrëse të publikut . Rritja e bashkëpunimit me OJF-të mjedisore.
- Fillimi i zbatimit të projektit të ri "Forcimi i rrjetit të monitorimit të mjedisit në Shqipëri" (STEMA2).
- Monitorimi i cilësisë së ajrit nga institucionet vendase – 2010.
-vëzhgimi i pikave të monitorimit

- matja e indikatorëve të ajrit (NO_x,PM₁₀,SO₂,CO, etj)

- Organizimi i trajnimeve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për natyrën dhe biodiversitetin.
- Sigurimi i materialeve njohëse dhe udhëzuese për autoritetet doganore për zbatimin e procedurave ligjore , për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës.
- Ngritja, funksionimi dhe trajnimi i stafit të administratave të zonave të mbrojtura.
- Organizimi i takimeve të komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura me përfaqësues të institucioneve qendrore, lokale dhe OJF-të mjedisore.
- Seminar për prezantimin e ligjit "Për gjuetinë" të miratuar në datën 11 mars 2010.
- Publikimi i materialeve sensibilizuese për zonat e mbrojtura dhe biodiversitet
- Organizimi i seminareve dhe trainimeve, për ndërgjegjësimin e publikut dhe të gjithë aktorëve që përfshihen në përdorimin e rezervave ujore, lidhur me zbatimin e ligjit të "Rezervave Ujore", të amenduara.
- Ndërgjegjësimi i publikut për zbatimin e projektligjit për krijimin e një rrjeti për veprimin në politikat e ujit.
- Krijimi i një sistemi ndërinstitucional për evidentimin e plotë të të gjitha aktiviteteve njerëzore dhe ndikimeve të tyre, në rajonet e baseneve të lumenjve.
- Krijimi i sistemit për identifikimin e instalimeve të mëdha industriale që i përkasin aneksit 1 të Direktivës IPPC.
- Krijimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit efektiv të instalimeve të djegies.
- Përcaktimi i autoritetit kompetent, që do të kryejë detyrat e detajuara në zbatim të Direktivës, SEVESO II.
- Krijimi i një sistemi notifikimi për përdorimin, përpunimin, ruajtjen e substancave të rrezikëshme për operatorët e instalimeve SEVESO.
- Trajnime të personelit të njesisë IPPC, inspektorëve që do të kontrollojnë instalimet IPPC, industrialistëve.
- Konsultime me palët e interesuara (industrialistët, Dhoma e Tregëtisë, Konfindustria, NGO) dhe me publikun.
- Zbatimi i projektit të plotë (UNDP/GEF, ndërtimi i kapaciteteve adaptuese në pritje të ndryshimeve të pritshme të klimës në zonën midis deltave të lumenjve Drini - Mati) nëpërmjet: zhvillimit të kapaciteteve për monitorim; futjes së riskut të NK në planet/programe e zones DMRD.
- Zbatimi i projektit të plotë (UNDP/GEF krijimi i tregut të paneleve diellore për ngrohjen e ujit).
- Zbatimi i projektit të plotë (UNDP/GEF, ndërtimi i kapaciteteve adaptuese në pritje të ndryshimeve të pritshme të klimës në zonën midis lumenjve Drini-Mati). Inspektime për zhurmat nga automjetet.
- Krijimi i një regjistri kombëtar tip, për zhurmat.
- Përmirësime strukturore të inspektoriatit.
- Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare për negociata në lidhje me kuotat e peshkimit dhe akuakulturës si dhe për zbatimin e rekomandimeve për menaxhimin e tonit të kuq.
- Kontrolli i aktivitetit të peshkimit në bashkëpunim me Rojën Bregdetare në kuadër të Qendrës së Përbashkët Operacionale Detare QPOD.
- Trajnime dhe mbështetje e stafit dhe inspektoriatit për standartet në fushën e peshkimit

në vendet komunitare.

- Trajnimi i stafit dhe subjekteve private për zbatimin e kushteve të akuakulturës organike dhe rregullave të reja të prodhimeve të akuakulturës në zbatim të rregulloreve të be të miratuara.

Aneks 3 INVESTIMET PUBLIKE

	Emërtimi i projektit të investimit	Projekt buxheti 2010
Nr.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve e Adminstrimit të Ujërave	400,000
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	10,000
	Orendi pajisje	10,000
	Rikonstruksion	
2	Programi për Mbrojtjen e Mjedisit	30,000
	TVSH	20,000
	Kosto Lokale	10,000
3	Mbështetje për Peshkimin	157,000
	Bankina Shëngjin	76,559
	Supervizor, Kolaudator Bankina Shëngjin	4,500
	Thellimi i Portit te Peshkimit Vlores	15,941
	TVSH-K.Lokale Projekti për Portin e ri të Peshkimit në Durrës	60,000
4	Administrimi i Pyjeve	203,000
	Pyllëzime	9,000
	Pyllëzime nga të ardhurat	50,000
	Orendi paisje D.Sh.P.	10,000
	Punime në zonat e mbrojtura	25,000
	Fidanishte	11,000
	Mirëmbajtje lerash	7,000
	Sistemime malore	15,000
	Rikonstruksion i zyrave të Shërbimit pyjor në rrethe	6,000
	K.lokale-Projekti i Zhvillimit të Burimeve natyrore (IDA)	45,000
	TVSH-Projekti i Zhvillimit të Burimeve natyrore (IDA)	25,000

Aneksi 4 PROJEKTE TË NDIHMËS SË HUAJ (2010)

Emri i projektit	Donatori/kredito ri	Kosto totale (mijë lekë)	Data e mbarimit
Programi "Për Mbrojtjen e Mjedisit"			
Projekti: PDF B: "Transformimi i tregut për përdorimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë në Shqipëri":	GEF/UNDP	10,000	2012
Projekti: PDF B "Identifikimi dhe zbatimi i masave për adaptimin në deltën e lumenjve Drini - Mati".	GEF/UNDP	15,000	2011
Projekti "Menaxhimi i integruar i ekosistemitte te liqenit të Shkodrës	GEF-WB	60,000	2012
Përgatitja e projektit «Për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të Liqenit të Prespës	GEF/UNDP	30,000	2011
Projekti "Forcimi i kapaciteteve për vendet e Ballkanit perëndimor për trajtimin e pikave të nxehta mjedisore sipas një modeli të integruar"	Qev. Hollandeze/UN DP	15,000	2010
Sistemi menaxhues per strategjine e mjedisit		65,000	
Ngritja dhe Forcimi i Sistemit Monitorues te kontrollit dhe mbikqyrjes (MCS), Blue Box	IPA 2008	65,000	2012
Plan veprimi per mjedisin lokal		5,720	
Fuqizimi i performances mjedisore te qeverisjes lokale.		26,000	
Programi "Mbështetje për Peshkim"			
Projekti për Portin e ri të Peshkimit në Durrës	Banka Islamike (kredi)	100,000	2010
Programi "Administrimit të Pyjeve"			
Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore	IDA (kredi) GEF/SIDA (grant)	123,000	2011
Total		514,720	

Aneksi 5 MASAT NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT

OBJEKTIVAT	MASAT	TREGUESIT MONITORUES
<p>Integrimi i parimit të transparencës me publikun në të gjitha aktet e reja ligjore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Integrimi në të gjitha projekt-aktet ligjore të neneve të veçanta që rrisin aksesin e publikut në vendimarrje. • Integrimi në të gjitha projekt-aktet ligjore të neneve të veçanta vendosin këshillimin publik si parakusht në miratimin e vendimeve. • Plotësimi i detyrimeve që lidhen me konsultimin e publikut dhe me aktorët e interesuar për aktet ligjore që hartohen si për shpalljen e ZM-ve të reja sipas dispozitave ligjore në fuqi • Projektvendim për informimin e publikut • Projektvendim për metodikën kombëtare të vlerësimit të ndikimit në mjedis • Projektligj për mbrojtjen e Mjedisit • Projektligj për lejet mjedisore 	<p>Projekt-akte të miratuara që integrojnë parimin e transparencës</p> <p>Projekt-akte të miratuara që integrojnë parimin e transparencës</p> <p>Konsultime publike për hartimin e akteve ligjore të dhe për shpalljen e Zonave të Mbrojtura të reja</p> <p>Krijimi i një procedure të posaçme për mënyrën e informimit të publikut për mjedisin.</p> <p>Publikimi elektronik i raporteve të VNM dhe mbledhja e komenteve të publikut në formë elektronike.</p> <p>Bashkëpunimi me Qendrat e Informimit të Publikut (AIC) në rrethe për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e VNM-së</p> <p>Përmirësimi i procedurave të transparencës dhe informimit.</p> <p>Përmirësimi i procedurave</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Projektligj për vlerësimin e ndikimit në mjedis 	të transparencës dhe informimit.
Rritja e transparencës dhe informimit të publikut për vendimarrjet mjedisore, monitorimet e treguesve mjedisor,	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi me qendrat e Informimit të publikut (AIC) në rrethë për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e VNM-së. • Publikimi i drafteve të akteve ligjore në websiten e MMPAU si dhe në faqe të tjera si REC Albania për marrjen e komenteve të mundshme. • Organizimi i workshopeve me aktoret e intresuar për fushën e mjedisit, pyetje dhe administrimit të ujërave. 	<p>Numri i informacioneve të kërkuara dhe të marra nga publiku</p> <p>Numri i akteve të publikuara</p> <p>Numri i takimeve të organiazuara</p>
Rritja e transparencës në planifikim, detajimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i komisioneve me përfaqësues nga çdo drejtori (që ka lidhje me fondet buxhetore) për hartimin e dokumentacionit final për planifikimin dhe detajimin e fondeve buxhetore • Ngritja e grupeve të kontrollit, me urdhër Ministri, me përfaqësues nga çdo drejtori me qëllim rritja e prezencës së strukturave të MMPAU-se gjatë menaxhimit të fondeve buxhetore • VKM "Për miratimin e normave të punimeve për aktivitete në pyje dhe kullota". • Bërja transparente e kërkesë – ofertës për monitorimet duke zbatuar VKM nr;1189 dt 18.11.2009. 	<p>Krijimi i komisioneve me përfaqësues nga çdo drejtori.</p> <p>Hartimi i dokumentacionit final për planifikimin dhe detajimin e fondeve buxhetore.</p> <p>Grupet e kontrollit të ngritura me përfaqësues nga çdo drejtori.</p> <p>Hartimi i manualit të normave dhe çmimeve për punimet pyjore e kullimore.</p> <p>Publikimi elektronik në website-in e ministrisë</p>
Ndarja e funksioneve	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i reformës 	Krijimi i 12 Drejtorive

<p>të menaxhimit dhe kontrollit me qëllim shmangien e konfliktit të interesit</p>	<p>institucionale në sektorin e pyjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekt-akt për krijimin e Drejtorive Rajonale të Policisë Pyjore • Krijimi i Drejtorive Rajonale të Menaxhimit të Pyjeve • Hartimi i rregulloreve të funksionimit për subjektet e varësisë. • Ndarje e qarte e detyrave të Inspektorit të Mjedisit, dhe Specialistit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit 	<p>Rajonale të shërbimit Pyjor në Qark</p> <p>Akt ligjor i miratuar</p> <p>Akt ligjor i miratuar</p> <p>Rregullore e miratuar</p> <p>Krijimi i strukturës së inspektoriatit të mjedisit</p>
<p>Zbatimi i reformës rregullatore të liçensimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të procedurave të vendosura për liçensimin e aktiviteteve në përdorimin e burimeve natyrore. 	<p>Evidentimi periodik i numrit të lejeve të miratuara .</p>
<p>Decentralizimi i mëtejshëm i vendimarrjes në menaxhimin e burimeve natyrore me qëllim afrimin e mëtejshëm të publikut me vendimarrjen</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i vazhdueshëm për kryerjen e procedurave në mënyrë të decentralizuar nga subjektet e varësisë, mbështetur në procedurat e konkurimit publik. • Vazhdimi i transferimit të pyjeve dhe kullotave në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore 	<p>Miratimi i Vendimit në Keshillin e Ministrave Hartimi i VKM dhe miratimi i tyre rast pas rasti.</p> <p>Sipërfaqja e transferuar</p>
<p>Forcimi i vazhdueshëm i kontrolleve kronologjike të ushtruara për aktivitetet e mjedist, pyjeve, peshkimit dhe ujërave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i plotë i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në mjedis. • Krijimin e listave të kontrollit të aktiviteteve. 	<p>Rritja e numrit të inspektimeve në 10% nga viti 2009, për subjekte me aktivitetet me ndikim në mjedis.</p> <p>Rritja e numrit të masave</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Verifikimin e subjekteve për paisje me leje mjedisore dhe zbatimin e detyrave dhe kushteve të përcaktuara në lejet mjedisore. • Ndarje e qartë e detyrave të Inspektorit të Mjedisit, dhe Specialistit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit 	<p>administrative.</p> <p>Ndalimi i veprimtarisë së aktiviteteve me ndikim në mjedis që nuk permbushin kuadrin ligjor</p>
<p>Monitorim i vazhdueshëm i shkallës së shfrytëzimit të inerteve lumore në basenet ujëmbledhese duke përmbushur kriteret teknike të përcaktuara në aktet ligjore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i programeve të kontrollit për periudhat e ndalimit të shfrytëzimit të inerteve lumore • Kordinimi i kontrolleve në bashkërendim me organet e qeverisjes vendore. 	<p>Kontrolli dhe inspektimet çdo muaj për shfrytëzimin me kriter të lumenjve.</p> <p>Masa me karakter administrativ</p>